VENDIM
Nr.183, datë 31.3.2005

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/6 KV, MAMURRAS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i nënstacionit 110/6 kV, Mamurras, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a., Tiranë.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronesohet, të kompensohet në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2233,1 m^2 tokë bujqësore arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 233 100 (dy milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind) lekësh.
4. Ky fond të përballohet nga fondet e investimeve të KESH sh.a., Tiranë, të miratuara për koston vendore për shpronësimet.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit të jetë në shumën 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) lekë dhe të përballohet nga KESH sh.a., kërkuesi për shpronësim.
6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit prill 2005 dhe të përfundojë brenda tremujorit të tretë të këtij viti.
7. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INDUSTRISË DHE ENERGJETIKËS

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË "NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110/6 kV MAMURRAS".

RRETHI: KURBIN
QYTETI: MAMURRAS

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet : **Tokë Bujqësore Arë**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sipërfaqja Përgjithshme m²	Çmimi lekë/m²	Vlera e kompesimit në lekë
1.	AVNI	RUSTEM	PEPA	Toke Arë	1676	438/27/4	2233.1	1000	2.233.100
	Totali								**2.233.100**

Sqarime :

Shpenzime procedurale : 1. Publikime 65.000 (gjashtedhjeteepesemije) leke
2.Shperblim anetareve te komisionit 20.000 (njezetemije) leke

Vlefta totale e shpronesimit = 2.233.100 + 85.000 = 2.318.100 leke.